



Sheshi "Erhard Busek", nr. 12, Prishtinë | Tel. fax: +383 38 248 940, +383 38 212 416
email: info.bkk@rks-gov.net | Ueb: www.biblioteka-ks.org

Bazuar në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, nenin 80 dhe 81 dhe nenin 89 të Ligjit për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës nr. 08/L-197, Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin nr. 04/L-097 për Bibliotekat, Statutin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Udhëzimin Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" shpall:

Konkurs

Institucioni: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Titulli i punës: Drejtor i Departamentit të Zhvillimit dhe i Përpunimit të Koleksioneve

Kategoria funksionale: Krijues/e dhe performues/e/artit dhe kulturës - drejtues i mesëm

Klasa e pozitës: K4

Koeficienti: 10

Nr. i kërkuar: 1

Kohëzgjatja e emërimit: Me mandat 4-vjeçar

Data e njoftimit: 22.08.2025

Afati për aplikim: 25.08.2025-24.09.2025

Numri i referencës: RN00018495

Kodi: RPC0012034

I përgjigjet: Drejtoreshës së përgjithshme të BKK-së

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Harton dhe realizon politika të zhvillimit dhe përpunimit të koleksioneve bibliotekare;
2. Harton dhe realizon politika për koleksione të veçanta;
3. Harton dhe realizon politika të kërkimit të informacionit bibliografik;
4. Udhëheq, organizon dhe mbikëqyr divizionet e departamentit;
5. Ushtron detyra dhe autorizime në përputhje me legjislacionin në fuqi;
6. Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së drejtorit të Përgjithshëm të BKK-së.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë zotësi të plotë veprimi sipas ligjit;
3. Ta njohë së paku njërën nga gjuhët zyrtare;
4. Të jetë i aftë shëndetësisht dhe profesionalisht për detyrën;
5. Të mos jetë i dënuar me dashje për vepër penale;
6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
7. Ta ketë arsimimin, përvojën profesionale dhe aftësitë e kërkuara;
8. T'i kalojë me sukses procedurat e pranimin.

Kriteret formale dhe specifike

Arsimimi: Diplomë e arsimit të lartë (niveli i parë - Bachelor).

Përvoja: Së paku pesë (5) vjet përvojë pune profesionale, duke përfshirë:

1. Tri (3) vjet përvojë në pozita drejtuese; ose
2. Dy (2) vjet në pozita drejtuese + diplomë master; ose
3. Një (1) vit në pozita drejtuese + diplomë doktorate.

Aftësi dhe njohuri:

1. Njohuri të thella profesionale në fushën bibliotekare;
2. Aftësi kërkimore, analitike dhe vlerësuese;
3. Aftësi për të dhënë kontribut në zhvillimin e politikave;
4. Aftësi komunikimi dhe përfaqësimi;

Dokumentet e nevojshme:

1. Letërnjoftim/pasaportë;
2. Diplomë e noterizuar dhe, nëse është e huaj, akti i nostrifikimit ose vërtetimi i procedurës së nostrifikimit;
3. Dëshmi për përvojën e punës (kontratë ose vërtetim);
4. Dëshmi që nuk ka masë disiplinore në institucion publik;
5. Certifikatë mbi dënimet penale jo më e vjetër se 6 muaj;
6. Dëshmi për trajnime të ndjekura ose të realizuara;
7. Dokumente shtesë që provojnë plotësimin e kushteve të shpalljes.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Bazuar në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, nenin 80 dhe 81 dhe nenin 89 të Ligjit për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës nr. 08/L-197, Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin nr. 04/L-097 për Bibliotekat, Statutin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” dhe Udhëzimin Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Paraqitja e kërkesave: Të interesuarit mund t’i dorëzojnë kërkesat e tyre dhe dokumentacionin në zyrën nr. 23, kati I, nga ora 09:00-15:00, apo përmes postës në adresën: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, Zyra e Personelit, nr. 23 (aplikim për punë), Sheshi “Erhard Busek”, nr. 12, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Data e njoftimit për aplikim në uebfaqen unike të procedurave të konkurrimit <https://konkursi.rks-gov.net> është nga data 25.08.2025, deri me datë 24.09.2025.

Përveç uebfaques unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në uebfaqen e BKK-së.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në Shërbimin Civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret në uebfaqen www.biblioteka-ks.org dhe dorëzohet në Zyrën nr. 23, kati I, nga ora 09:00-15:00, apo përmes postës në adresën: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, Zyra e Personelit nr. 23 (aplikim për punë), Sheshi “Erhard Busek”, nr. 12, 10000, Prishtinë, Kosovë.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.